

Kthim pergjigje nr. 162 Wed 4/8/2020 5:06 PM

To: contact@ecoalbania.org;

Pershendetje Z. Nika!

Duke ju falenderuar ne mirekuptimin tuaj, per kohen e marre nga ne, ne kthimin e pergjigjes të kërkesës dërguar me shkresen nr. 213 Prot, date 28.02.2020 në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në kuadër të Ligjit 119/2014 datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”, regjistruar me nr. 162, në regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve, e cila ishte në përputhje me nenin 11 të ligjit të sipërcituar, **lutem gjeni bashkengjitur informacionin e kerkuar.**

Per subjektet, te cilat nuk ishin te shoqëruar me NIPT-in përkatës, nuk gjenerohet informacion.

Faleminderit për mirëkuptimin.

Hermelinda Hysenaj
Specialiste e Sektorit te Asistences dhe Sherbimit
Drejtoria e Sherbimit ndaj Tatimpaguesve
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Tel Office : 04 2276 840

Web: www.tatime.gov.al

Kthim pergjigje nr. 162 Thu 4/9/2020 4:16 PM

To: contact@ecoalbania.org;

Pershendetje Z. Nika!

Ne vijim te kerkeses tuaj, sqarojme si me poshte vijon:

Në Ligjin nr. 9920/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, *neni 24 “Dhënia e informacionit tatimor nga administrata tatimore”* përcaktohet se, informacioni tatimor për tatimpaguesin, i administruar nga administrata tatimore, u ofrohet pa pagesë autoriteteve të përcaktuara në këtë nen, pas depozitimit të kërkesës me shkrim dhe kur verifikohen rrethanat e mëposhtme:

- a) gjyqtarit, nëse është në gjykim ose në hetim të një çështjeje civile, të lidhur me një tatimpagues, për pjesën që u takon marrëdhënieve të tij me administratën tatimore;
- b) gjyqtarit apo prokurorit, nëse është në gjykim ose në hetim të një çështjeje

penale, të lidhur me një tatimpagues, për pjesën që u takon marrëdhënieve të tij me administratën tatimore;

c) Kontrollit të Lartë të Shtetit, vetëm për rastet, kur kërkesa e bërë është në funksion të kontrollit të kryer nga ky institucion ndaj administratës tatimore, në funksion të hartimit të rekomandimeve të veta;

ç) autoritetit të ngjashëm të huaj, me të cilin Kuvendi ka ratifikuar marrëveshje ndërkombëtare dhe informacioni kërkohet në kuadër të ekzekutimit të marrëveshjes;

d) autoritetit homolog të huaj ose autoriteteve vendase, me të cilat Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dy ose shumëpalëshe, me objekt shkëmbimin e informacionit;

dh) institucioneve të pavarura, të krijuara me ligj;

e) çdo autoriteti tjetër, sipas parashikimit të bërë me ligj të veçantë.

Si dhe neni 31 “E drejta për konfidencialitetin e të dhënave”

1. Çdo tatimpagues ka të drejtën e konfidencialitetit për të dhënat e veta tatimore e financiare, të administruara nga administrata tatimore.

2. E dhënë tatimore dhe financiare është çdo informacion, i cili merret nga administrata tatimore, gjatë ushtrimit të funksioneve, tek tatimpaguesi ose palët e treta.

Per sa me siper, referuar Ligjit Nr. 9920/2008 "Per Procedurat Tatimore ne RSH" i ndryshuar, nenet 24, 25 dhe 31, Administrata Tatimore nuk mund t'ju vere ne dispozicion informacionin e kerkuar.

Faleminderit per mirekuptimin.

Pune te mbare

Hermelinda Hysenaj
Specialiste e Sektorit te Asistences dhe Sherbimit
Drejtoria e Sherbimit ndaj Tatimpaguesve

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Tel Office : 04 2276 840

Web: www.tatime.gov.al